

MARREVESHJE PER BLERJEN E KUOTAVE

NDERMJET

DELOITTE & TOUCHE EASTERN EUROPE SA

Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, organizuar sipas ligjeve te Belgjikes, me seli ne 17, rue Archimede, 1000 Brukel, Belgjike.

Nr. i regjistrimit 535255 ne Regjistrin Tregtar te Brukselit

Perfaqesuar nga drejtori i saj z. Trevor Wallinger.

I cili me poshte do te quhet "Shitesi."

DHE

DTCE HOLDINGS LIMITED

Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, organizuar sipas ligjeve te Republikes se Qipros, me seli ne Eftapaton Court, 256 Archibishop Makarios, III Avenue, 3301 Limassol, Cyprus

Numuri i regjistrimit nr. 84799

Perfaqesuar nga administratori i saj z. Thomas Flanagan

I cili me poshte do te quhet "Bleresi."

MEQENESE

Palet i perkasin te njejtes Organizate Nderkombetare te quajtur Deloitte & Touche Tohmatsu;

Shitesi zoteron te gjitha kuotat e shoqerise Deloitte & Touche SH.P.K., qe ne vijim do te quhet "Shoqeria;"

Ne kuadrin e punes per riorganizimin boteror te veprimtarive ne Evropen Qendrore te shoqerise Deloitte & Touche Tohmatsu, Shitesi deshiron qe t'i shese bleresit kuotat ("Koutat") qe ai zoteron ne Shoqeri, dhe Bleresi deshiron qe te bleje Kuotat nga Shitesi;

PALET BIEN DAKORT SI ME POSHTE VIJON:

NENI 1 – OBJEKTI

- 1.1 Shitesi i shet Bleresit, ne perputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara ne kete kontrate, 100% te Kuotave te Shoqerise, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e organizuar sipas ligjeve te Shqiperise, me seli ne VeVe Business Center, Tirane, Shqiperi.
- 1.2 Shitesi deklaron dhe e garanton Bleresin se ka te drejte absolute per te disponuar Kuotat, sic percaktohet ne nenin 1.1 ne çfaredolloj menyre qe ai e konsideron te arsyeshme.
- 1.3 Bleresi deklaron se e njuh shume mire Shoqerine dhe biznesin qe ajo zhvillon.

1.4 Transferimi i Kuotave dhe i pasurive te tjera hyn ne fuqi duke filluar nga data 1 Janar 1999 dhe Bleresi gezon te drejta te plota pronesie per Kuotat dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin siç jane te drejtat mbi dividendin, duke filluar nga kjo date. Palet garantojne kryerjen e menjehershme te te gjitha formaliteteve te nevojshme per realizimin e kesaj marreveshje.

NENI 2 – ÇMIMI

2.1. Çmimi i blerjes se Kuotave do te jete vlere nominale e Kuotave.

2.2. Palet bien dakort qe Bleresi t'i paguaje Shitesit çmimin e shitjes brenda 30 diteve pasi palet te kene percaktuar çmimin ne perputhje me nenin 2.1

NENI 3 – TAKSAT

Te gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera qe lidhen me shitjen dhe transferimin e Kuotave ne kete Marreveshje do te paguhen nga Shitesi.

NENI 4- LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo Marreveshje, me perjashtim ne masen kur kerkohet ndryshe nga ligji, do te udhëhiqet dhe interpretohet, ne perputhje me ligjet e Belgjikes.

NENI 5- ARBITRAZHI

Cdo mosmarreveshje ndermjet paleve ne lidhje me vlefshmerine, interpretimin ose permbushjen e kesaj Marreveshje do te zgjidhet ekskluzivisht dhe ne menyre perfundimtare, ne perputhje me rregullat Cepani (Cepani eshte korespondenti Belg i Gjykates se Arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregetise) nga nje arbiter i emeruar ne perputhje me rregullat Cepani. Arbitrazhi do te zhvillohet ne Bruksel (Belgjik), ne Anglisht.

NENI 6 – TE NDRYSHME

6.1. Njoftimi

Njoftimet e nevojshme behen me leter, e cila dorezohet personalisht ose me poste te regjistruar ose te vertetuar ne adresen qe vijon:

Shitesit:

Deloitte & Touche Eastern Europe
17 Rue Archimede
1000 Brussels

Nje kopje i drejtohet Z. T. Wallinger
c/o Deloitte & Touche



Bleresit:

Tyn 641/4
110 00 Prague 1
Czech Republic

DTCE Holdings Ltd
Eftapaton Court
256 Archbishop Makarios III Avenue
3301 Limassol
Republic of Cyprus

6.2 Teresia e Marreveshjes

Kjo marreveshje perben te gjithë marreveshjen ndermjet paleve dhe konfirmon qarte se nuk ka marreveshje ose zotime, gojore apo me shkrim, perveç asaj qe eshte permendur ketu.

6.3 Ndryshimi dhe heqja dore

Asnje ndryshim, heqje dore apo modifikim i percaktimeve te kesaj marreveshje nuk ka vlere ne rast se nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet nga te dy palet.
Moszbatimi i dispozitave te Marreveshjes nga ana e paleve nuk do te interpretohet si heqje dore nga marreveshja ose nga e drejta qe kane palet per te zbatuar keto dispozita.

6.4 Titujt

Titujt e kesaj Marreveshje sherbejne vetem per te lehtesuar referencat.

6.5 Pavlefshmeria e pjeseshme

Ne qofte se ndonje nga dispozitat e kesaj marreveshje behet e pavlefshme ose e pazbatueshme apo marreveshja rezulton me boshlleqe, kjo nuk ndikon ne vlefshmerine e dispozitave te tjera te kontrates. Ne vend te dispozitave te pavlefshme, korrigjimit te boshlleqeve apo zevendesimit te dispozitave mbi pamundesine, do te arrihet nje rregullim i pershtateshme nga te dy palet, ne masen qe ligjerisht eshte e mundur, e cila do te transmetoje qellimet qe kishin ose do te kishin palet, ne rast se do te vleresohej ceshtja ne driten e kuptimit dhe qellimit te Marreveshjes

Lidhur ne Prage, Republika e Cekise, ne daten 5 Janar 1999, bere ne 4 formate origjinale, ku secila pale pranon se ka terhequr origjinalin te nenshkruar dhe nga pala tjetere.

Deloitte & Touche Eastern Europe
Shitesi
Trevor J. Wallinger (Firma)

DTCE Holdings Ltd
Bleresi
Thomas Flanagan (Firma)

Perkthyer nga Anglishtja ne Shqip
Nga Elona RUDHA